

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "BST STAR" SH. P. K.

Sot, më datën 04/09/2020 Zj. Estel Tepshi, e lindur në Durres, datë 04/04/2002, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, vendosi të themelojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "BST STAR" Sh. P. K. si më poshtë vijon:

Neni 1

Personi fizikë i sipërpërmendur, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojn shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin "BST STAR" Sh. P. K.

Ortak i vetëm i shoqërisë është Zj. Estel Tepshi

Administratore e kësaj shoqërie caktohet Zj. Estel Tepshi

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria "BST STAR" Sh. P. K. gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Sh. P. K.". Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë "BST STAR" Sh. P. K është Lagjja nr. 1, "Rruga " Anastas Durrsaku " , zona kadastrale 8518, nr. pasurise 21/129, Durres.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe te pa caktuar.

Neni 4

Shoqëria do të kryejë aktivitet me objekt:

- Sherbim transporti per udhetare , linje autobuzi brenda dhe jashte vendit.
- Import- export i te gjitha materialeve industriale.
- Sherbime imobilare.

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 Leke. Kapitali i shoqerise ndahet ne nje numer kuotash ne raport me kontributin e dhene nga cdo ortak ne shoqeri ku cdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri, kuota keto te shlyera teresisht nga ortaku i vetem:

Zj. Estel Tepshi zoteron nje kuote me vlere 100.000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta). Ortaku i vetem pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 6

Fitimi neto nga aktiviteti i kesaj shoqerie i perket ortakut te saj.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e kësaj shoqërie, pasi e lexuan me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjetën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tyre, e firmosën pa vërejtje.

ORTAKU I SHOQËRISË

ESTEL TEP SHI

